

V E N D I M
Nr. 51, datë 30.7.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica, më datë 13.7.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.49 Akti që i përket :

KËRKUES: AVNI SHEHU, i përfaqësuar nga avokatët Halil Kopani, Stavri Çeço, Maksim Haxhia e Artan Hajdari, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PRESIDENTI I REPUBLIKËS, i përfaqësuar nga zoti Theodhori Sollaku, me autorizim.

O B J E K T I :

Pakushtetutshmëria e dekretit nr.2386, datë 7.6.1999 të Presidentit të Republikës. Njohjen e së drejtës për të vazhduar mandatin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

b Kërkuesi Avni Shehu pretendon se Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 2386, datë 7.6.1999 “Për emërimin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, është antikushtetues pasi ka shkelur të drejtën kushtetuese të vazhdimin të mandatit të Kryetarit të kësaj gjykate duke arsyetuar se:

- Emërimi i Kryetarit të Gjykatës së Lartë është bërë pa më mbaruar mandati im 7-vjeçar si Kryetar i kësaj gjykate;
- Asnjë organ kompetent nuk është shprehur për mbarimin ose ndërprerjen e mandatit tim;
- Emërimi i Kryetarit të ri të Gjykatës së Lartë është kryer pa u boshatisur në aspektin juridik ky funksion kushtetues dhe pa m’u garantuar e drejta e mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit, të përfaqësuesve të tij, të përfaqësuesit të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Kërkuesi Avni Shehu me vendim të Kuvendit Popullor nr.225, datë 12.5.1992 është zgjedhur zëvendëskryetar i Gjykatës së Kasacionit për një periudhë 7-vjeçare. Me vendimin nr.270, datë 21.9.1995, ai është zgjedhur në detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit. Presidenti i Republikës më datën 15.5.1999, në bazë të nenit 136, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës, ka filluar procedurën për marrjen e pëlqimit nga Kuvendi për Kryetarin dhe për disa anëtar të Gjykatës së Lartë. Pasi Kuvendi me vendimin nr.406, datë 20.5.1999 e ka dhënë këtë pëlqim, Presidenti i Republikës me Dekretin nr.2386, datë 7.6.1999 ka emëruar Kryetarin e ri të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, si rrjedhojë e emërimit të Kryetarit të ri të Gjykatës së Lartë, kërkuesi Avni Shehu i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar antikushtetutshmërinë e Dekretit të Presidentit të Republikës si dhe njohjen e së drejtës për të vazhduar mandatin e Kryetarit të kësaj Gjykate.

Duke analizuar përmbajtjen e nenit 6 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” (që sipas nenit 179 të Kushtetutës, është ligji i zbatueshëm për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët janë zgjedhur më parë si gjyqtarë të Gjykatës së Kasacionit), Gjykata Kushtetuese konstaton se dispozita konkrete kushtetuese nuk e veçon, përkundrazi e njëson mandatin e gjyqtarit me atë të Kryetarit të kësaj gjykate. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, mandati i anëtarit, i zëvendëskryetarit dhe i Kryetarit të

Gjykatës së Kasacionit, janë të unifikuar në mandatin e gjyqtarit. Pikërisht nga pasja e cilësisë themelore të gjyqtarit të gjykatës së Kasacionit, buron edhe funksioni i Kryetarit dhe i zëvendëskryetarit të kësaj gjykate, si drejtues administrativ. Vetë kjo dispozitë kushtetuese parashikon një afat mandati prej 7-vjetësh, si për gjyqtarin ashtu dhe për Kryetarin pa patur qëllimin për të vënë gjyqtarin në një pozitë të ndryshme dhe të pabarabartë në raport me të tjerët.

Jo vetëm dispozita konkrete, por dhe në tërësi, i gjithë ligji i mëparshëm kushtetues, kur trajton kriteret e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit, afatin e zgjedhjes së tyre, heqjen e imunitetit, mënyrën e procedimit penal apo shkarkimin nga detyra, nuk ka parasysh disa mandate, por ai trajton dhe shprehet vetëm për një lloj mandati, pikërisht për mandatin e gjyqtarit të Gjykatës së Kasacionit. Këtë trajtim e bën edhe neni 14 i këtij ligji, i cili njësion imunitetin dhe të drejtat e tjera kushtetuese apo ligjore të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të zëvendësit të tij me mandatin e gjyqtarit të Gjykatës së Kasacionit.

Koncepti ligjor për një lloj mandati, atë të gjyqtarit, gjen shprehjen e vet në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1985, në pikën 12 të së cilës përcaktohet se: "... gjykatësit, qofshin të emëruar ose të zgjedhur, nuk mund të hiqen derisa... nuk kanë arritur fundin e mandatit të vet", gjithashtu dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e cila mban po të njëjtin qëndrim. Si në pjesën e nëntë të Kreut, "Gjykata", veçanërisht në nenet 136 deri 140 dhe në Kreun "Gjykata Kushtetuese", nenet 125 deri 130 etj., Kushtetuta, njeh dhe pranon si mandat, atë të gjyqtarit. Në këtë kontekst, duhet interpretuar dhe neni 179, pika 2 e Kushtetutës, që për të zgjidhur problemin e vazhdimin të organeve kushtetuese pas hyrjes në fuqi të kësaj kushtetute, i unifikon të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Kasacionit, pa përjashtuar as zëvendëskryetarët dhe Kryetarin e saj me përcaktimin se: "Anëtarët e Gjykatës së Kasacionit vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës së Lartë, sipas mandatit të mëparshëm".

Nga ky këndvështrim i problemit, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesi ka fituar në datën 12.5.1992 mandatin e gjyqtarit dhe njëkohësisht funksionin e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Kasacionit me një afat 7-vjeçar, mandat i cili përfundonte më datën 12.5.1999. Fakti që në datën 21.9.1995, kërkuesi është zgjedhur në detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, nuk është në favor dhe as nuk i shërben argumentit që ai paraqet për të arritur në përfundimin, se atij i është ndërprerë mandati i gjyqtarit dhe po në këtë datë i ka filluar përsëri një mandat i ri gjyqtari me afat të ri 7-vjeçar. Koncepti ndërprerje mandati që përdor kërkuesi nuk gjen mbështetje si në dispozitat e mëparshme kushtetuese, ashtu dhe në Kushtetutë, pasi mandati i gjyqtarit vetëm mund të fitohet, ose të mbaroj. Mandati i gjyqtarit fitohet për një afat 7-vjeçar dhe vetëm në përfundim të këtij afati, por jo më parë, sipas nenit 6 të ligjit kushtetues, mund të rifitohej një mandat i ri gjyqtari, nëpërmjet rizgjedhjes. Pra, është rizgjedhja i vetmi moment juridik, ajo që krijon një marrëdhënie të re juridike për gjyqtarin. Ndërsa kërkuesi, duke qenë i pajisur me mandatin e gjyqtarit që në vitin 1992, nuk mundej që të rifitonte mandatin e ri 7-vjeçar përpara përfundimit të këtij afati. Mbarimi përpara afatit i mandatit të gjyqtarit sigurisht që mund të ndodhë dhe ky është një moment që njihet në praktikën kushtetuese dhe ligjore, por vetëm nëse vërtetohen ato raste, të cilat nuk kanë të bëjnë me mbarimin natyreshëm dhe ne rrugën normale të tij, siç mund të jenë dorëheqja, arritja e moshës së pensionit, dënimi me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi etj.

Për kërkuesin nuk rezulton ndonjë rast i tillë, pasi ngritja e tij në një funksion më të lartë brenda institucionit, nga detyra e zëvendëskryetarit në atë të Kryetarit nuk sjell mbarimin përpara afatit të mandatit, sepse mandati i gjyqtarit ka vazhduar vetvetiu, Pikërisht kjo zgjedhje e kërkuesit në detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, nuk mund të interpretohet si fitim i një mandati të ri 7-vjeçar për të, sepse vetë ligji i mëparshëm kushtetues nuk e koncepton mandatin e kryetarit të veçantë nga mandati i gjyqtarit, si dhe për më tepër nuk ka qenë aspak ky qëllimi i ligjvënësit dhe i dispozitës konkrete që të vendosë Kryetarin e Gjykatës së Kasacionit në një pozicion shumë më të favorshëm dhe më të privilegjuar në raport me gjyqtarin.

Pretendimi i kërkuesit se asnjë organ kompetent nuk është shprehur për mbarimin ose ndërprerjen e mandatit të tij është i pabazuar, për arsye se mbarimi i mandatit në mënyrë normale dhe në afatin e caktuar nuk mund të deklarohen, pasi nuk është nga ato raste të veçanta, që parashikon shprehimisht Kushtetuta. Sipas neneve 127 dhe 139 të

Kushtetutës, janë vetëm Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë organet që kanë të drejtë të deklarojnë mbarimin e mandatit për gjyqtarët respektivë. Duke i bërë një interpretim literal dhe të zgjeruar nenit 139 në tërësinë e tij, Gjykata Kushtetuese çmon se kjo dispozitë ka të bëjë vetëm për

rastet kur mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron përpara afatit të tij, pra në rrugë jo të zakonshme. Dhe pikërisht duke qenë se për të gjitha këto raste është e domosdoshme kryerja e një verifikimi dhe konstatimi të faktit të ndodhur si dhe për të ruajtur të pacënuar parimin e pavarësisë së gjykatës, Kushtetuta ia ka njohur këtë të drejtë Gjykatës së Lartë, që të shprehet me vendim. Edhe për rastin konkret, si rrjedhojë e kërkesës që ka paraqitur kërkuesi Avni Shehu përpara këtij organi, për t'u shprehur dhe deklaruar për mandatin e tij dhe të disa gjyqtarëve të tjerë, Gjykata e Lartë duke iu referuar nenit 139 të Kushtetutës nuk e ka konsideruar shqyrtimin e kësaj çështje dhe daljen me vendim si kompetencë të saj, pasi kjo dispozitë i ka sanksionuar në mënyrë të qarta rastet, sipas të cilave, ajo duhet të vendosë lidhur me deklarin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit. Ky qëndrim i Gjykatës së Lartë vlerësohet edhe në përputhje me nenin 124 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta e interpretimit përfundimtar të Kushtetutës i përket vetëm Gjykatës Kushtetuese, si organi që garanton respektimin e saj.

Lidhur me mbarimin normal, të zakonshëm dhe në afatin e caktuar të mandatit, jo vetëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, por dhe për organe të tjera të rëndësishme, si për Kuvendin, Presidentin e Republikës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, deputetët, Avokatin e Popullit, Guvernatorin e Bankës, etj., Kushtetuta nuk parashikon ndonjë procedurë të caktuar dhe as organin konkret që duhet të shprehet dhe të deklarohet për ta.

Mjafton plotësimi i afatit të caktuar kohor për organin ose funksionin konkret, ashtu siç mund të ndodhë edhe në rastin e vdekjes së personit, që mandati të konsiderohet i përfunduar normalisht si dhe funksioni kushtetues i boshatisur njëkohësisht në aspektin juridik që sipas Kushtetutës, organi kompetent të fillojë procedura për zgjedhjen e personit tjetër. Në këto kushte nuk ekzistonte asnjë detyrim kushtetues, apo ligjor, sipas të cilit, personit apo organit, në rastin konkret kërkuesit Avni Shehu, të cilit i ka mbaruar natyrshëm mandati, t'i komunikojë mbarimi i mandatit me anë të një akti formal.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se procedura e kryer nga Presidenti i Republikës në funksion të detyrave të tij kushtetuese për marrjen e pëlqimit dhe kryerjen e emërimit të Kryetarit të ri të Gjykatës së Lartë, ka qenë në përputhje me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE ;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/a dhe 134/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 41 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumice votash,

V E N D O S I

Prëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkuesi, pakushtetutshmërinë e Dekretit nr.2386, datë 7.6.1999 përpiqet ta argumentojë në dy drejtime kryesore:

Së pari, atij nuk i ka mbaruar mandati;

Së dyti, asnjë organ kompetent nuk është shprehur për mbarimin ose ndërprerjen e mandatit.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe në vendim, shumica padrejtësisht i ka kushtuar vend të veçantë e të gjerë sqarimit të problemit të parë, duke arritur në konkluzion se për rastin në fjalë mandati ka mbaruar.

Ky qëndrim është i gabuar, jo për pozicionin që mbahet përfundimisht, por për investimin e Gjykatës në këtë aspekt.

Të vesh në diskutim nëse ka mbaruar ose jo mandati, do të thotë të diskutosh

kushtetutshmërinë e dekretit nr.2386, datë 7.6.1999, objekt ky për të cilin, në bazë të nenit 134 të Kushtetutës, Gjykatën Kushtetuese nuk mund ta verë në lëvizje një individ, qoftë ky dhe kryetar i Gjykatës së Lartë.

Në këto kushte, shumica në vendim nuk kish pse të shprehej për përfundimin e mandatit; qëndrimi i vetëm dhe i drejtë kushtetues do të ishte mospranimi i këtij argumenti për mungesë legjitimitimi të kërkuesit.

Ndryshe qëndron problemi me pretendimin e kërkuesit se për mbarimin e mandatit të tij nuk është shprehur organi i parashikuar nga Kushtetuta. Duke ngritur një pretendim të tillë, kërkuesi ka synuar të argumentojë se akti objekt kërkese është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor. Duke qenë kështu, kërkesa për këtë shkak është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkuesi legjitimohet në bazë të Kushtetutës ta ngrerë atë.

Kërkesa për këtë shkak duhej pranuar. Procedurave për zëvendësimin e kërkuesit nga funksioni i kryetarit të Gjykatës së Lartë, detyrimisht duhej t'u paraprihej me deklarinë e Gjykatës së Lartë për mbarimin e mandatit. Një përfundim i tillë del nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës e konkretisht i neneve 139, 140 etj.

Interpretimi i këtyre dispozitave, në radhë të parë duhet t'i nënshtrohet frymës në tërësi të Kushtetutës, e cila jo vetëm sanksionon të drejta por dhe i garanton ato. Nëse për mbarimin e mandatit për rastet e pikës 1 të nenit 139 të Kushtetutës garanci është shqyrtimi e deklarimi i rastit me vendim të Gjykatës së Lartë, për çfarë garanci kushtetuese mund të flitej nëse mandati mbaron për shkaqe të tjera (që në fakt nuk janë parashikuar, por që në jetë realisht ekzistojnë), si mbarimi i afatit, vërtetimi i papërshtatshmërisë (lindur pas emërimit), emërimi në një detyrë të re.

Mendimi ynë ka qenë dhe mbetet se edhe për këto raste ka garanci kushtetuese. Deklarimi i mbarimit të mandatit nga Gjykata e Lartë është i domosdoshëm jo vetëm për rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 139, por në tërësi për të gjitha rastet e mbarimit të mandatit.

Edhe po të pranojmë për një moment si të drejtë tezën e shumicës se pika 2 e nenit 139 të Kushtetutës vlen vetëm për rastet e parashikuara në pikën 1, teza e jonë për një proces të parregullt ligjor qëndron në një aspekt tjetër.

Po t'u referohesh dokumenteve shkresore del se lidhur me mbarimin ose jo të mandatit të kryetarit të Gjykatës së Lartë, ka ekzistuar një keqkuptim (në mos konflikt) midis këtij dhe institucionit të Presidentit. Ky konflikt mund dhe duhej zgjidhur në rrugë të rregullt institucionale e jo në rrugën që u ndoq, ku mangësitë janë evidente. Kështu, bie fjala edhe pse i vetmi organ që interpreton Kushtetutën është Gjykata Kushtetuese dhe në rastin në shqyrtim ka qenë e domosdoshme që ajo të vihej në lëvizje, këtë funksion e ka marrë përsipër ta kryejë aparati i Presidencës, duke bërë interpretimin e Kushtetutës në shkresën nr.572, datë 18.5.1999.

Po kështu, është për t'u përmendur shkresa që Presidenti i Republikës i dërgon Kuvendit për marrjen e pëlqimit ku shprehimisht thuhet se kërkuesit i ka mbaruar mandati si kryetar i Gjykatës së Lartë. Pavaërisht nga forma, ky është një deklarim zyrtar, i cili në referim të dispozitave kushtetuese e veçanërisht të nenit 94, nuk është në kompetencë të Presidentit.

Për arsyet e përmendura më lart, kam shfaqur mendimin se zëvendësimi i kryetarit të Gjykatës së Lartë me arsyetim se i ka mbaruar mandati, pa u shprehur konkretisht organi kompetent (Gjykata e Lartë) përbën një proces të parregullt, e për pasojë akti i marrë si rezultat i këtij procesi duhej shfuqizuar, duke i lënë kështu rrugë të lirë një procedure normale kushtetuese.

A N Ë T A R I
A. Karamuço

MENDIMI I PAKICËS

Në kërkesën e tij kërkuesi Avni Shehu ka paraqitur arsyet për pakushtetutshmërinë e Dekretit nr.2386, datë 7.6.1999.

Në thelb kërkesa përmban dy argumente: së pari, se kërkuesit nuk i ka mbaruar mandati dhe së dyti, se për mbarimin e mandatit të tij nuk ishte shprehur asnjë organ kompetent.

Për të vërtetuar të kundërtën e pretendimeve të kërkuesit, vendimi i shumicës në tërësinë e tij argumenton se mandati i ka mbaruar edhe si kryetar edhe si gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Duke marrë përsipër një detyrë të tillë që të shprehet për mbarimin e mandatit, kam mendimin se Gjykata

Kushtetuese ka dalë tej caqeve të kompetencave të saj të përcaktuara në nenin 131 dhe nene të tjera të Kushtetutës. Nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të deklarojë mbarimin ose jo të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Në rast se do të ishte e nevojshme që një organ duhej të shprehej për mbarimin ose jo të mandatit, ky organ do të ishte vetëm Gjykata e Lartë, ashtu siç përcaktohet në paragrafin e dytë të nenit 139 të Kushtetutës dhe kjo duhej bërë përpara se të fillonin procedurat për emërimin e kryetarit të ri të Gjykatës së Lartë.

Përderisa kishte një konflikt lidhur me faktin nëse kishte mbaruar ose jo mandati, gjykoj se për të siguruar garancitë kushtetuese edhe për shkaqe të tjera, të mbarimit të mandatit, si në rastin konkret, Gjykata e Lartë në vështrim të nenit 139 duhej të shprehej me vendim për këtë çështje.

Duke patur këtë mendim në lidhje me problemin e kompetencës dhe me procedurat që duheshin ndjekur, votova kundër vendimit të shumicës.

A N Ë T A R I
H. FUGA

MENDIMI I PAKICËS

Pajtohem me vendimin që u muarr me shumicë votash, vetëm në pjesën që përligj largimin e zotit Avni Shehu nga detyra e kryetarit të Gjykatës së Lartë, por jo për shkaqet e pranura nga shumica.

Përsa i përket pjesës tjetër, ku pranohet se të lartpërmendurit i ka mbaruar edhe mandati i anëtarit të kësaj Gjykate dhe për rrjedhojë ai nuk duhet ta ushtrojë më as këtë funksion, unë kam mendim krejtësisht të kundërt.

Duke i analizuar të dyja këto pjesë të vendimit, qëndrimi im për secilën është ky:

Kërkuesit i ka mbaruar mandati si kryetar i Gjykatës së Kasacionit qysh në momentin që ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Re e Republikës së Shqipërisë.

Është e vërtetë se edhe më pas ai ka ushtruar defakto edhe funksionet e kryetarit të Gjykatës së Lartë, por pa qenë i caktuar në këtë detyrë nga organi kompetent, sipas procedurës së re që parashikon Kushtetuta. Pikëpamja e anëtarëve të tjerë të Gjykatës Kushtetuese, se kjo e drejtë i buronte atij nga neni 179 i Kushtetutës, nuk më duket e drejtë.

Kam mendimin se kësaj dispozite nuk duhet t'i bëhet interpretim i zgjeruar. Ndryshe një qëndrim i tillë, nuk do të pajtohej me qëllimin e vërtetë që ka pasur ligjvënësi kushtetues, i cili ka qenë i interesuar për ndryshime të thella, sidomos në organin drejtues të kësaj hallke kryesore të sistemit gjyqësor.

Për rrjedhojë, kur në këtë normë kushtetuese thuhet se anëtarët e Gjykatës së Kasacionit, do të vazhdojnë të jenë anëtarë të Gjykatës së Lartë deri në mbarim të mandatit të mëparshëm, është pasur parasysh funksioni i tyre si gjyqtarë, duke përfshirë këtu edhe kërkuesin, por vetëm me këtë cilësi dhe jo edhe me cilësinë e tij si kryetar i kësaj Gjykate.

Pra, vetë Kushtetuta këtë vend e ka lënë qysh në fillim vakant, dhe i ka njohur të drejtën Presidentit të Republikës ta plotësojë atë me një emërim të ri duke marrë pëlqimin paraprak të Kuvendit. Megjithatë një veprim i tillë nuk duhej të cënonte mandatin e kërkuesit si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, që për mendimin tim nuk i ka mbaruar më 15 maj të këtij viti, por duhet t'i vazhdojë deri në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin muaj të vitit 2002. Kjo për arsye se ai është zgjedhur kryetar i Gjykatës së Kasacionit në vitin 1995, kohë kur ishte në fuqi Ligji "Për dispozitat kryesore kushtetuese", së bashku me plotësimet e ndryshimet e tij të mvonshme.

Në bazë të dispozitave të këtij ligji, për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Kasacionit nuk kërkohej që ky të ishte i zgjedhur më përpara anëtar i kësaj Gjykate. Pra, mënyra e fitimit të postit të kryetarit ishte origjinale dhe jo e prejdardhur ose e kondicionuar nga qenia më parë në detyrën e gjyqtarit. Në këtë drejtim ka ecur edhe praktika kushtetuese në rastin e caktimit si kryetarë të Gjykatës së Kasacionit, të zotërinjve Nuro Hoti e Zef Brozi, të cilët janë ngarkuar me këtë funksion, pa qenë fare ose pa u zgjedhur më parë anëtarë të kësaj Gjykate.

Duke interpretuar dispozitat e ligjit të sipërpërmendur del se personi i zgjedhur si kryetar i Gjykatës së Kasacionit automatikisht fitonte edhe statusin e gjyqtarit. Në qoftë se ai zgjidhej nga radhët e anëtarëve, mandati i tij si gjyqtar ripërtërihej dhe zgjatej edhe 7 vjet të tjera, pra për aq kohë

sa ai do të vazhdonte të ushtronte funksionet e kryetarit, sepse parashikohej shprehimisht e drejta e rizgjedhjes, si për kryetarin ashtu edhe për anëtarët e Gjykatës së Kasacionit.

Megjithatë, në rast se kryetari heq dorë ose për shkaqe të tjera largohet nga ky funksion, si atëhere edhe sot nuk ka ndonjë pengesë ligjore për të vazhduar mandatin e tij si gjyqtar, derisa të plotësohet afati fillestar i caktuar për kryetarin e Gjykatës së Kasacionit ose kryetarin e Gjykatës së Lartë.

Pikërisht, duke iu përmbajtur këtij kriteri, unë mendoj se Kushtetuta e Re i ka hequr atij vetëm të drejtën për të vazhduar mandatin e mëparshëm në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Lartë, por jo edhe të drejtën për të vazhduar si anëtar i kësaj Gjykate, derisa të plotësohet afati 7 vjeçar, i cili fillon nga dita që është zgjedhur kryetar i Gjykatës së Kasacionit, dmth., më datë 15 maj 1995.

Në këto rrethana, procedura e ndjekur nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë, e pasqyruar kjo në aktet e tyre përkatëse është e drejtë vetëm përse i përket spostimit të kërkuesit nga posti i kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe emërimi në këtë detyrë i një personi tjetër; ndërsa të gjitha veprimet e tjera që kanë të bëjnë me largimin e tij edhe nga detyra e gjyqtarit të kësaj gjykate, përpara vitit 2001, për mua përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës, sepse çënojnë jo vetëm parimin e pavarësisë së gjykatave, por edhe të drejtën themelore të çdo gjyqtari si individ, të cilit nuk mund t'i hiqen të drejtat e fituara me ligj pa një proces të rregullt ligjor.

Prandaj, duke u nisur nga këto konsiderata, unë mendoj se një zgjidhje e drejtë e çështjes në shqyrtim, do të realizohej në këtë mënyrë:

Të rrëzohej kërkesa për shfuqizimin e Dekretit të Presidentit të Republikës, që emëron në vend të kërkuesit, si kryetar të Gjykatës së Lartë zotin Thimjo Kondi, por të shfuqizoheshin si antikushtetuese të gjitha aktet e tjera të Presidentit dhe të Kuvendit, me të cilat është deklaruar edhe mbarimi i mandatit të kërkuesit si anëtar i Gjykatës së Lartë.

A N Ë T A R
Z. Vuci

Tiranë, më 30.7.1999

Nr. 49 i regjistrimit themeltar
Nr. 51 i vendimit